



## Vendim Shpjegues Publik Nr. 04/2009

### **Borxhet e Organizatave Buxhetore si rezultat i Ndëshkimeve**

Ky vendim shpjegues publik është nxjerrë në përputhje me Nenin 9 të Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar me Ligjin 03/L-071, i cili i jep Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore autorizim që të lëshojë vendime shpjeguese publike sipas nevojës për interpretimin dhe implementimin e legjislacionit tatimor në fuqi në Kosovë.

Ky vendim shpjegues publik është nxjerrë për të qartësuar detyrimet e organizatave buxhetore në lidhje me ndëshkimet administrative për mos-dorëzim me kohë të deklaratave dhe mos-pagesë me kohë të detyrimeve tatimore.

Duke pasur parasysh se Administrata Tatimore ka vlerësuar ndëshkimet kundër organizatave buxhetore për dorëzimin e deklaratave tatimore pas afatit dhe për pagesë të tatimit pas periudhës kohore të paraparë me ligj;

Duke marrë parasysh nenin 44 të Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar me Ligjin 03/L-071, i cili parasheh si vijon:

*44.1 Kur një person kërkohet të dorëzojë një deklaratë tatimore sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, nuk e dorëzon këtë deri në datën e kërkuar, personi i tillë do t'i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ prej pesë përqindë (5%) të tatimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit për të cilin është vonuar, me një ndëshkim maksimal administrativ për pagesë prej njëzet e pesë përqind (25%) të obligimit tatimor.*

*44.2 Kur një person kërkohet të paguajë një tatim sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, nuk paguan tërë apo një pjesë të tatimit të tillë deri në datën e kërkuar, personi i tillë do t'i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ prej një përqind (1%) të obligimit tatimor për secilin muaj apo pjesë të muajit për të cilën ajo pagesë është vonuar, deri në maksimum dymbëdhjetë (12) muaj.*

Duke marrë parasysh se Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat përkufizon personin si, “një person fizik apo një entitet” dhe se Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat “entitetin” e përkufizon si: “korporatë apo shoqëri tjetër tregtare që ka statusin e një personi juridik sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/6 të 8 Shkurtit 2001 “Shoqëritë Tregtare”, një shoqëri tregtare që operon me pasuri me pronësi publike apo shoqërore, një organizatë jo-qeveritare e regjistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/22 të 15 Nëntorit 1999 “mbi Regjistrimin dhe Funkcionimin e Organizatave Jo-Qeveritare në Kosovë,” dhe një njësi e përhershme e një jo-rezidenti,

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, nxjerrë “vendimin shpjegues publik” si më poshtë:

Një organizatë buxhetore nuk aplikohet në personin sikurse është përkufizuar në Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-071. Si rrjedhim ndëshkimi për dorëzim të deklaratës pas datës së vënë për dorëzimin e deklaratës tatimore dhe ndëshkimi për mos-pagesë të detyrimit tatimor deri në datën e paraparë për pagesat e tilla, (Neni 44 i Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-071) **nuk aplikohet në organizatat buxhetore.**

Megjithatë ky vendim shpjegues, nuk i liron organizatat buxhetore nga përgjegjësia e tyre të dorëzojnë deklaratat brenda kohës së paraparë me legjislacionin tatimorë. Rastet e përsëritura në dorëzimin e deklaratave apo pagesës së detyrimeve tatimore pas kohës së paraparë me Legjislacion, do t'i referohen Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për veprime të duhura disiplinore.

Behxhet Haliti  
Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së



Data: 15/09/2009